



Dr. Ledina Mandija
Lektore, Fakulteti Juridik,
Universiteti i Tiranës/
Avokate

ARBITRAZHI AD HOC DHE
INSTITUCIONAL

Në terma të organizimit dhe funksionimit, arbitrazhi mund të jetë: (i) *ad hoc*, (ii) institucional ose i kombinuar (një formë e kombinuar e dy formave të mëparshme).

A. Arbitrazhi Ad Hoc

Arbitrazhi *ad hoc* i referohet arbitrazhit që nuk është i supervizuar ose i kontrolluar nga një trup institucional. Një arbitrazh *ad hoc* është një procedurë arbitrazhi, bazuar mbi të cilën tribunali i arbitrazhit kontrollon çdo aspekt të procedurave të varura nga çdo rregull për të cilin palët mund të bien dakord.

Artikulli 4 i Konventës së Gjenevës përcakton që palët në një marrëveshje arbitrazhi duhet të jenë të lirë ta çojnë mosmarrëveshjen ndërmjet tyre në një gjykatë të përhershme arbitrazhi ose në një procedurë të arbitrazhit *ad hoc*.

Në rast se palët e referojnë mosmarrëveshjen midis tyre tek procedurat *ad hoc*, kjo do të thotë, ndër të tjera, që ato që ato kanë të drejtën të caktojnë arbitrat ose të vendosin për emërimin e arbitrave në rastin e një marrëveshjeje; të përcaktojnë vendin e arbitrazhit dhe të vendosin për procedurën e zbatueshme nga arbitrat.

Në rastin e arbitrazhit *ad hoc*, klauzola e arbitrazhit hartohet nga palët në formën e një kontrate. Në rast mosmarrëveshjeje, palët mund ta aplikojnë këtë klauzolë, të zgjedhin arbitrat dhe të bien dakord rreth rregullave procedurale për zhvillimin e

procesit të arbitrazhit.

Arbitrazhi *ad hoc* është një procedurë arbitrazhi e cila nuk administrohet nga të tjerët, por vetë palët arrijnë një marrëveshje midis tyre për zgjedhjen e arbitrave, përcaktimin e rregullave të arbitrazhit, ligjet zbatuese dhe ndihmën e nevojshme procedurale dhe administrative gjatë arbitrazhit.

Në këtë rast, nuk ka rregulla të përfshira dhe asnjë autoritet të caktuar të emëruar. Në rast se palët nuk janë në gjendje të bien dakord për emërimin e një tribunali arbitrazhi, zakonisht, janë gjykatat e vendit të arbitrazhit që emërojnë arbitrin ose tribunalin e arbitrazhit.

Teorikisht, ky lloj arbitrazhi duhet të jetë më elastik, më i shpejtë dhe më ekonomik. Në praktikë, rezulton se kushtet e negocimit pas lindjes së mosmarrëveshjes, në momentin kur kërkohet zakonisht zbatimi i këtij lloji të arbitrazhit, janë shumë më të vështira sesa para se të lindë mosmarrëveshja.

Në këto kushte, koha e negocimit për zgjedhjen e arbitrave për të vendosur rregullat e arbitrazhit, ligjet që zbatohen, si dhe asistencën procedurale dhe administrative për zbatim, bëhet jashtëzakonisht e rëndësishme dhe zvogëlon kohën e fituar nga një proces më i thjeshtë të arbitrazhit.

Një tjetër anë pozitive është kostoja e tij më e ulët. Palët mund të paguajnë vetëm tarifatat për arbitrat, avokatët, përfaqësuesit e tyre dhe kostot për zhvillimin e arbitrazhit.

Kështu që ata nuk paguajnë tarifën e kostove institucionale, të cilat, zakonisht, përcaktohen në varësi të vlerës së kërkesës së arbitrazhit.

Për sa u përket kostove financiare, palët dhe arbitrat mund të bien dakord për kryerjen e arbitrazhit në zyrat e arbitrave. Në këtë lloj arbitrazhi, palët bien dakord t'i negociojnë tarifën me arbitrat, ndërsa në arbitrazhin institucional tarifën e arbitrave i paguhen institucionit dhe, zakonisht, bëhen publike. Një arbitrazh *ad hoc* është i përshtatur me nevojat e palëve rast pas rasti dhe është më i efektshëm sesa arbitrazhi institucional.

Praktika ka treguar se arbitrazhi *ad hoc* është vështirë të funksionojë krejtësisht i ndarë nga arbitrazhi institucional, pasi është pothuajse e pamundur që pasi mosmarrëveshja të lindë midis palëve, palët të bien dakord për zgjedhjen e një arbitri të paanshëm, rregullat procedurale për zhvillimin e arbitrazhit, etj.

Në shumicën e arbitrazheve *ad hoc*, do të ketë referim ose përfshirje të një sere rregullash që palët bien dakord të pranojnë. Këto mund të bëhen në përputhje me marrëveshjen e veçantë ose të jenë rregullat e një organi si UNCITRAL-i. Shumë nga këto rregulla përfshijnë dispozita përbazuar në rregullat e arbitrazhit të UNCITRAL-it nuk kanë përse të jenë në pozicion më të keq se ato, për shembull, që janë bazuar në rregullat e arbitrazhit të ICC-së. Në qoftë se palët në arbitrazhin *ad hoc* bien dakord të përdorin ICC-në ose LCIA-në si autoritetin emëruar, ato mund të ndihen të sigurta që, në mungesë të marrëveshjes për zgjedhjen e tribunalit të arbitrazhit, ato do të emërohen shpejt nga një institucion i njohur, kompetent dhe i respektuar.

B. Arbitrazhi Institucional

Marrëveshja e arbitrazhit duhet të përcaktojë nëse palët do t'i drejtohen një arbitrazhi ose një institucioni arbitrazhi *ad hoc*.

Rregullat e arbitrazhit sigurojnë kornizën në të cilën do të zhvillohen procedurat e arbitrazhit. Është e zakonshme që për këto rregulla të bihet dakord kur marrëveshja e arbitrazhit është në zhvillim e sipër. Në këtë drejtim, palët mund të zgjedhin nëse do ta kryejnë arbitrazhin e tyre bazuar mbi rregulla institucionale ose mbi rregulla arbitrazhi *ad hoc*.

Sipas Artikullit 4 të Konventës së Gjenevës, nëse palët e kalojnë mosmarrëveshjen ndërmjet tyre për zgjidhje të një institucioni përhershëm arbitrazhi, procedurat e arbitrazhit do të zhvillohen në përputhje me rregullat e institucionit të arbitrazhit. Klauzola që përcakton referencën për arbitrazhin institucional e detyron këtë institucion ta zhvillojë arbitrazhin sipas rregullave të tij dhe rregullat e institucionit të arbitrazhit bëhen pjesë e marrëveshjes së arbitrazhit.

Arbitrazhi institucional është arbitrazh i administruar nga një trupë ose organizatë specifike.

Palët mund të caktojnë arbitrat e tyre, por bien dakord që arbitrazhi duhet të drejtohet mbi një sërë rregullash institucionale. Institucioni mund të mos luajë rol ose të luajë vetëm një rol të limituar në arbitrazh. Në mënyrë të ngjashme, palët mund të zgjedhin rregullat *ad hoc* për arbitrazhin e tyre, por bien dakord për një autoritet emëruar, si Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC), ose Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar i Londrës (LCIA), ose Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve (ICDR), për emërimin e tribunalit të arbitrazhit.



Në 45 vitet e fundit, ka pasur rritje eksponenciale të arbitrazhit tregtar ndërkombëtar.

Kjo vjen, kryesisht, për shkak të globalizmit të tregtisë dhe zhvillimit të komunikimit të menjëhershëm. Shumë nga institucionet e arbitrazhit janë krijuar 35 vitet e fundit dhe suksesi i tyre është ende për t'u matur. Më poshtë, është dhënë një përmbledhje e institucioneve më të njohura të arbitrazhit që merren me arbitrazhin tregtar ndërkombëtar: Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar në Londër; Shoqata Amerikane e Arbitrazhit dhe Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve; Instituti i Arbitrazhit i Dhomës së Tregtisë në Stokholm; Qendra e Arbitrazhit Ndërkombëtar e Singaporit; Qendra e Arbitrazhit Ndërkombëtar e Hong Kongut; Instituti i Arbitrazhit i Holandës; Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit Tregtar të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Federatës Ruse; Shoqata e Arbitrave Detarë të Londrës; Organizata Botërore e Pronës Intelektuale; Institucioni Gjerman i Arbitrazhit; Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

Konsiderohet se një nga disavantazhet e arbitrazhit institucional është kostoja financiare e këtij arbitrazhit fundit, e cila priret të jetë më i lartë sesa ajo e arbitrazhit *ad hoc*. Kohëzgjatja e procesit të arbitrazhit nuk është një tregues i favorshëm i arbitrazhit institucional sepse kohëzgjatja e këtij të fundit nuk varet tërësisht nga palët. Disa nga avantazhet e arbitrazhit institucional janë:

- i. Mbron palët nga pasojat e pafavorshme të një procesi arbitrazhi. Arbitrazhi institucional maksimalizon vakuumin në ligjin procedural ose material që mund të haset gjatë procesit të arbitrazhit;
- ii. Institucionet e Arbitrazhit me reputacion

- të gjerë ndërkombëtar garantojnë një tribunal të pavarur arbitrazhi, të aftë për të administruar procesin e arbitrazhit pa u ndikuar nga bindjet politike dhe ekonomike. Në arbitrazhin *ad hoc*, caktimi i arbitrazhit, zakonisht, bazohet te besimi i palëve tek arbitrat dhe jo domosdoshmërisht te kualifikimet dhe përvoja e tyre. Institucionet mundësojnë emërimin e arbitrave me pëlqimin e palëve, por edhe pa ndërhyrjen e tyre;
- iii. Ndihma administrative nga institucionet e arbitrazhit. Arbitrazhet institucionale vënë në dispozicion një staf administrativ, i cili është, jo vetëm teknik, por edhe profesional dhe ndihmon të gjithë procesin e arbitrazhit, si interpretimin e rregullores dhe monitorimin e procedurës së arbitrazhit, në mënyrë që të sigurojë lëshimin e vendimit brenda afateve të përcaktuara.
- iv. Në disa raste, ai ofron një mundësi të mëtejshme për të apeluar kundër vendimit të arbitrazhit, siç është procedura e shqyrtimit të apelit nga një gjykatë apeli.

Duke pasur parasysh gjithë avantazhet dhe disavantazhet e tij, praktika tregtare ndërkombëtare ka treguar se arbitrazhi *ad hoc* është i përshtatshëm vetëm për mosmarrëveshje që përfshijnë pretendime relativisht të vogla, me pak palë ndërgjyqëse, si dhe, kryesisht, për arbitrazhet vendase, përveç rastit kur palët janë shtete. Arbitrazhi institucional është më i përshtatshëm ndonëse, në dukje, është më i kushtueshëm. Merr më shumë kohë dhe është me i ngurtë se arbitrazhi *ad hoc*, por garanton më tepër mbështetje, kontroll dhe proces monitorimi dhe rishikim të vendimeve sesa arbitrazhi *ad hoc*, dhe, ç'është më e



më e rëndësishmja, forcon besueshmërinë e vendimeve të arbitrazhit.

Gjykata e arbitrazhit e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë është një nga shembujt më të dukshëm të institucionit të arbitrazhit.

ICC-ja në Paris themeloi Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit të ICC-së në 1923. Arbitrazhi ICC është i përcaktuar për mosmarrëveshje tregtare ndërkombëtare dhe ICC-ja konsiderohet, përgjithësisht, si institucioni kryesor ndërkombëtar i arbitrazhit tregtar në botë. Roli i ICC-së në arbitrazh është i gjerë. ICC-ja, sekretariati i saj dhe gjykata e Arbitrazhit janë përgjegjëse për shërbimin e Kërkesës për Arbitrazh, fiksimin e paradhënies në kosto, konfirmimin e emërimit të tribunalit të arbitrazhit dhe emërimin e gjykatës së arbitrazhit në mungesë të marrëveshjes. Gjykata e Arbitrazhit gjithashtu merret me sfidat ndaj pavarësisë së tribunalit të arbitrazhit dhe shqyrtimin e vendimeve të tribunalit të arbitrazhit. Gjykata e Arbitrazhit nuk vendos për bazueshmërinë e mosmarrëveshjes. Kjo i lihet tribunalit të arbitrazhit. Roli i Gjykatës së Arbitrazhit është më së shumti administrativ, megjithëse ka dhe rol mbikëqyrës kur shqyrton kushtet e një vendimi. Megjithëse ICC-ja është e bazuar në Paris, arbitrazhet mund të zhvillohen në çdo vend të botës. Arbitrazhi i ICC-së, ndonjëherë, është kritikuar si i shtrenjtë. Sidoqoftë, arbitrazhi i ICC-së është efektiv dhe cilësia e vendimeve që burojnë nga gjykatat e ICC-së është zakonisht e standardit më të lartë.

Përgjegjësia e autorit: Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë artikull janë vetëm deklarata personale të autorit dhe nuk pasqyrojnë

domosdoshmërisht pozicionin e ICC Albania. Përmbajtja e artikullit është punim origjinal i autorit. Autori merr përgjegjësinë për çdo shkelje të autorësisë.

Versioni origjinal i artikullit është në gjuhën angleze.

